



Pranuar / Dërguarat Primljen / Prudato Received / Delivered	08.03.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtojç / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHKIC	2508/2023		114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.151/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.151/2023 të datës 25.01.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 07.03.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Apropohet si e bazuar** ankesa më numër A.nr.151/2023 e datës 25.01.2023, e parashtruar nga ankuesi

**II. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15 ditësh) nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë kompensimin e pagave të plota për ankuesin për muajin gusht, shtator, tetor, dhe nëntor 2022, diferencën e pagës së papaguar për muajin dhjetor 2022, si dhe pagesën e pagës për periudhën nga data 01.01.2023 deri në nxjerrjen e Vendimit A.nr.1099/2022 të datës 18.01.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke përfshirë edhe kompensimin e detyrimeve ligjore lidhur me pagat.

**III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi më datë 25.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 809/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mohimit të së drejtës për kompensim material të pagave.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa Këshilli më datë 21.02.2023 ka pranuar shkresat lidhur çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 809/2022 të datës 25.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin për përfaqësim i datës 02.08.2022; Gjendja e llogarisë bankare për ankuesin për periudhën 01.06.2022 deri 20.01.2023; Vendimin me Nr.Ref:129/2022 të datës 21.04.2022; Vendimin me Nr.Ref: 466/2022 të datës 22.07.2022 të Komisionit për Grada dhe Disiplinë i MPJD; Vendimin me Nr.Ref:560/2022 të datës 17.10.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin A.nr.716/2022 të datës 18.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokollit 4816/2022 të datës 19.08.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 1474/2023 të datës 07.03.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 1958/2023 të datës 21.02.2023; Shkresën nga MPJD për kalkulim të pagës për periudhën 17.10.2022 deri 07.11.2022; Vendimin me Nr. Ref: 237/2022 të datës 20.07.2022; Vendimin me numër protokollit 4747 të datës 07.11.2022 të Komisionit Disiplinor të MPJD-së; Listën e pagave për ankuesin dhjetor 2022, Kartelën e nëpunësi për periudhën qershor -dhjetor 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e bazuar, SEPSE:**

Nga administrimit i provave materiale rezulton së ankuesi ka qenë i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diaspore. Ndaj të njëjtit ishte iniciuar procedurë disiplinore në Komisionin për Grada dhe Disiplinë mbi bazën e kryerjes së shkeljeve të rënda disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit diplomatik. Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me Vendimin Nr.Ref:237/2022 të datës 20.07.2022 ka shpallur përgjegjës ankuesin dhe ka propozuar shqiptimin e masës disiplinore *Largim nga Shërbimi i Jashtëm*, ndërsa Ministria e MPJD-së bazuar në këtë vendim ka nxjerr Vendimin Nr.Ref:466/2022 të datës 22.07.2022, përmes të cilit ankuesit Imer Lladrovi i ka shqiptuar masën disiplinore "largim nga shërbimi civil", kurse më Vendimin Nr.ref.560/2022 të datës 17.10.2022 ka bërë shfuqizimin e Vendimit me Nr.Ref: 466/2022 të datës 22.07.2022. Pas këtij procesi është iniciuar procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, i cili me Vendimin me numër protokollit 4747 të datës 07.11.2022 ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore "largim nga shërbimi civil", ndërsa, Këshilli në procedurë të ankesës me Vendimin A.nr.1099/2022 të datës 18.01.2023 ka lënë në fuqi Vendimin me numër protokollit 4747 të datës 07.11.2022.

Ankuesi në ankesën e datës 25.01.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së ankuesit i është mohuar e drejta e kompensimit material të pagës për faktin së ankuesit në kundërshtim me nenin 130 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i është bërë ndalesa e pagës nga data e nxjerrjes së Vendimit me Nr.ref:466/2022 të datës 22.07.2022. Rrjedhimisht ka propozuar që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të obligoj Sekretarin e Përgjithshëm të MPJD-së që ankuesit ti bëjë kompensimin e pagave të plota për muajin gusht, shtator, tetor dhe nëntor 2022, diferencën e papaguar të pagës për muajin dhjetor 2022 si dhe pagën e muajit janar 2022, së bashku me të gjitha beneficionet deri në përfundim të procedimit ankimor sipas ankesës së datës 05.12.2022.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë ka konstatuar së ankuesit që nga nxjerrja e Vendimit Nr.ref:466/2022 të datës 22.07.2022 të Ministres së MPJD-së, i është ndalur pagesa e pagës, përkatësisht sipas kartelës së nëpunësit Imer Lladrovci në këtë rast ankuesit, rezulton së ankuesi nuk kishte marrë pagë për muajin gusht, shtator, tetor dhe nëntor 2022, ndërsa në muajin dhjetor ankuesit i është bërë një pagesë në vlerën prej 414.08 Euro, e cila shumë sipas përgjigjes në ankesë ka të bëjë më periudhën nga data 17.10.2022 deri më datë 07.11.2022.

Me tej, nga shqyrtimi i prova të lëndës Kolegji konstaton së ankuesi ka atakuar me ankesë të gjitha aktet administrative të nxjerra gjatë procedurës disiplinore të iniciuar ndaj tij, rrjedhimisht ankuesi ka atakuar në Këshill Vendimin me Nr. Ref: 466/2022 të datës 22.07.2022 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Vendimin me numër protokollit 4747 të datës 07.11.2022 të Komisionit Disiplinor, andaj, mbi gjendjen e këtyre fakteve si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 144 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilin është përcaktuar se: *"1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës"*, Kolegji i Këshillit konstaton së parashtrimi i ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ka pezulluar efektin juridik të Vendimit Nr. Ref: 466/2022 të datës 22.07.2022 të Ministres së MPJD-së dhe Vendimit me numër protokollit 4747 të datës 07.11.2022 të Komisionit Disiplinor të MPJD-së, kështu që mbi këtë bazë rezulton së janë të bazuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e kompensimit të pagave të ndaluara të ankuesit deri në përfundim të procedimit ankimor sipas ankesës së datës 05.12.2022.

Bazuar në konstatimet si me sipër, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15 ditësh) nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë kompensimin e pagave të plota për ankuesin për muajin gusht, shtator, tetor, dhe nëntor 2022, diferencën e pagës se papaguar për muajin dhjetor 2022, si dhe pagesën e pagës për periudhën nga data 01.01.2023

deri në nxjerrjen e Vendimit A.nr.1099/2022 të datës 18.01.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke përfshirë edhe kompensimin e detyrimeve ligjore lidhur me pagat.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.151/2023.

**Avdyll BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

